



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 589/24 Dt. 26.09.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për lejimin e mjeteve

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit bazuar në kërkesën e Teatrit të Qytetit “Bekim Fehmiu” në Prizren, për lejimin e udhëtimit zyrtar të Burim Mustafa -drejtor i TQ “Bekim Fehmiu”, Xhevdet Doda-aktor, Alban Krasniqi,-aktor, Alban Cela,-aktor, Valmira Hoti, -aktore dhe Edona Sopaj,-aktore, për pjesëmarrje në Festivalin Ndërkombëtar të Shekspirit”, që do të mbahet nga data 26 tetor 2024 deri me 28 tetor 2024 në Vlorë të Republikës së Shqipërisë, kështu që, për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve për të lartcekurit.
2. Teatri i Qytetit “Bekim Fehmiu” në këtë Festival do të paraqitet me shfaqjen artistike teatrore “Masë për Masë”.
3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohen nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit të Komunës.
4. Obligohet Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, TQ “Bekim Fehmiu” dhe Drejtoria për Ekonomi dhe Financa për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Teatrit të Qytetit,
 - Arkivës së Kryetarit.

